



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 486/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur”, me nr. REF-65966-07-20-2020 me objekt: “Loti 3 - Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 28,557,137 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.08.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: “4 S” sh.p.k.
Lagjia: “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Cajupi” pranë shkollës “Liri Kazazi” Lushnje.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve te Perqendruara
Sheshi Skënderbej, Nr,3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur*”, me nr. REF-65966-07-20-2020 me objekt: “*Loti 3 - "Blerje mish dhe nënproduktet e tij"*”, me fond limit 28,557,137 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.08.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Në datën 14.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor në datë 27.08.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------|------------------------------|
| 1. “4 S ” sh.p.k. | 21,518,500 leke skualifikuar |
| 2. “Kazazi-Meat” sh.p.k. | 21,846,220 leke skualifikuar |
| 3. “M.C Catering” sh.p.k. | 22,074,700 leke kualifikuar |
| 4. “Argent Daci | 23,594,130 leke skulifikuar |
| 5. “Nika” sh.p.k. | 23,989,710 leke skualifikuar |
| 6. Agim Hysi | 27,629,990 leke skualifikuar |

II.4. Në datën 27.08.2020 operatori ekonomik “4 S” sh.p.k., është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

Operatori Ekonomik, nuk plotëson pikën 5 (Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetim nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ku të vërtetohet se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore), të seksionit 2.3, Kapaciteti teknik, pika 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqisi vërtetim nga AKU-ja, për të vërtetuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

II.5. Në datën 02.09.2020 operatori ekonomik “4 S” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon: [...] *Skualifikimi i Shoqërisë “4 S” Shpk nuk plotëson pikën 5 (Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë vërtetim nga Ak i Ushqimit ku vërtetohet se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore), të seksionit 2.3, Kapaciteti teknik pika II, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqisi vërtetim nga AKU-ja, për të vërtetuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.*

Gjykojme se është i padrejtë dhe i pa bazuar për arsyet si më poshtë:

Në pikën 5 mbi kapacitetin teknik të kriterëve të veçanta për kualifikimin kërkohet :

OE pjesëmarrës duhet të paraqisi vërtetim nga AKU-ja ku vërtetohet se, kontrolli i fundit i ushtruar nga AKU-ja ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Në datën që në Rekomandimin e përbashkët AKU- APP të datës 19/11/2018, nën pikën g) mbi Hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, përcaktohet se:

OE duhet të operojë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore

Në përmbushje të sa më sipër, kemi paraqitur Procesverbalin e Inspektimit nga AKU Tiranë të datës 10/04/202, i cili deri në momentin e hapjes së ofertave është inspektimi i fundit i kryer nga AKU në shoqërinë tonë.

Nga Procesverbali i inspektimit i paraqitur konstatohet se:

1- Nuk ka shkelje të kërkesave ligjore

2- OBU ushtron aktivitet furre buke. Kushtet higjieno sanitare të përshtatshme. Punonjësi të pajisur me maska, doreza dhe përdorim dizinfektant. Është larguar prerëse e bukës nga tregtimi. Nuk konstaton mangësi nga Inspektimi.

Procesverbali i Inspektimit është firmosur rregullisht nga Inspektorët përkatës si dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë.

Shtojme se në kërkesën e tij në pikën 5 mbi kapacitetin teknik të kriterëve të veçanta për kualifikim, AK nuk ka përcaktuar një periudhë kohore brenda së cilës duhet të jetë lëshuar dokumenti i kërkuar. Në rast se AK mund dhe duhet t'i drejtohet AKU për verifikimin e të dhënave të paraqitura, pasi në të kundërt operatorët ekonomikë një vërtetim të vjetër mund ta paraqesin si ...inspektim të fundit të suksesshem për sa kohë Ak nuk përcakton një afat kohor brenda të cilit duhet të jetë lëshuar dokument, apo detyrimin

për paraqitje të deklaratës në ditën e hapjes së ofertave sic përcaktohet në rekomandimin e përbashkët AKU-APP. Nese paraqitet një vërtetim spo inspektim i sukseshem i leshuar gjatë periudhës së përgatitjes së dokumentacionit për pjesëmarrje në tender, serish jemi në kushtet e parregullsisë dhe nevojës së verifikimit, pasi AKU rezervo të drejten që të kryejë inpektime të paparashikuara, qoftë edhe 1 ditë përpara hapjes se ofertave.

Referuar sa më sipër, procesvebali i inspektimit i paraqitur prej nesh përmbush kriterin kualifikues dhe vërteton që nga kontrolli i fundit i kryer nga AKU ka rezultuar se subjekti ushton aktivitet konform kërkesave ligjore.

Kërkojmë pezullimin e vazhdimit të procedures dhe kualifikimin e ofertes se Shoqerise “4 S” Shpk, si oferte që plotëson të gjitha kushtet kualifikuese të përcaktuara ne DST.

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.1734/2 prot, datë 08.09.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “4 S”sh.p.k., duke e refuzuar atë me pretendimin si më poshtë:

[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi “4 S” SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi skualifikimin e ofertës së tij konstatoi se:

Për ofertuesin “4 S” SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar dhe dhënë automatikisht nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik më datë 27.08.2020, arsyet e skualifikimin të ofertës së tij si vijon: “Operatori Ekonomik, nuk plotëson pikën 5 (Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetim nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ku të vërtetohet se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik piak II , Kriteret e vecanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesi vërtetim nga AKU-ja për të vërtetuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.”

KSHA, Verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga Ofruesi “4 S” SHPK dhe kontatoi:

Në dokumentat e tenderit në kriterin në shtojcën nr. 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nënpika 5 përcaktohet se operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetim nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ku të vërtetohet se nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka rezultuar se subjekti ushton aktivitet konform kërkesave ligjore.

Nga verifikimi i dokumretacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi ka paraqitur dokumentin me emërtimin “Inspektim AKU Tiranë dt 10.04.2020 AS”, i cili rezulton të jetë Procesverbal Inspektimi nr. AKU-TR-2020-001857-2 datë 10.04.2020.

Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme bazuar dhe në pikën 1, të nenit 46 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontrates që do të prokurohet dhe jodiskriminuese...”.

Gjithashtu, sqarojmë se në rast se ofertuesi do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor në zbatim të nenin 42, pika II të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “...Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit”,

Në nenin 53 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se :”. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në ëriuthe me të qitha kërkesat dhe sreci ikimete rërcaktuara në n'o timin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”. Për sa më sipër, mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesave të përcaktuara dokumentet e tenderit, në oferten e paraqitur nga operatori ekonomik ofertues, përbën kusht për skualifikim. Për arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit “4 S” SHPK nuk pranohet.

II.7. Në datën 11.09.2020 operatori ekonomik “4 S” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1837/1prot., datë.21.09.2020, protokolluar me tonën në datën 23.09.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me argumentin se *“Operatori Ekonomik, nuk plotëson pikën 5 (Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetim nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ku të vërtetohet se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore), të seksionit 2.3, Kapaciteti teknik, pika 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqisi vërtetim nga AKU-ja, për të vërtetuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 5, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetim nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ku të vërtetohet se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumentacioni me emërtimin Inspektim AKU Tiranë dt. 10.04.2020 4 S, ku konstatohet se është paraqitur një Procesverbal Inspektimi datë 10.04.2020 i mbajtur nga punonjësit e AKU – Dega Rajonale e Qarkut Tiranë për subjektin “4 S” sh.p.k.

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, konstaton se nga ky i fundit është përcaktuar dhe kërkuar qartësisht një vërtetim, që është një dokument i lëshuar nga autoriteti kompetent, pra nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në të cilin duhet të pasqyrohen qartësisht disa elementë të tillë si: dokumenti të jetë i lëshuar nga AKU pra nga titullari që përfaqëson këtë institucion, ndërkohë që në rastin konkret dokumenti i paraqitur nga ankimuesi është thjesht një procesverbal i mbajtur nga disa punonjës të këtij institucioni të cilët janë autorizuar nga titullari i institucionit për të kryer një inspektim të tillë ; dokumenti duhet të përmbajë të përcaktuar qartë vërtetimin e faktit që kontrolli i kryer është i fundit, pra në vërtetim duhet të shprehet qartë dhe nëpërmjet të tij të vërtetohet dhe evidentohet fakti i rezultateve nga kontrolli i fundit (AKU në vërtetim do të shprehë qartë datën e kontrollit të fundit me qëllim evitimin e paqartësive); gjithashtu dokumenti duhet të përmbajë edhe elementin që nga subjekti ushtron kontroll konform kërkesave ligjore.

Pra sa më sipër analizuar, vërtetimi i kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit përmban disa të dhëna të vlefshme e të domosdoshme për autoriteti kontraktor për të verifikuar nëse një operator ekonomik disponon këto kapacitete, për më tepër, kur objekti i prokurimit ka të bëjë me produktin bukë gruri dhe simite.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në këtë rast kemi të bëjmë me një mungesë fizike dokumentacioni, pasi me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nuk arrihet të vërtetohet kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ai është thjesht një procesverbal i mbajtur nga grupi i inspektimit dhe nuk pasqyron aktin përfundimtar – vërtetimin në këtë rast sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor e ka përcaktuar qartësisht që kërkon një vërtetim nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, vërtetim ky i cili në vetvete ashtu siç edhe sqaruam më lart, përmban disa elementë e të dhëna të cilat i vërtetojnë autoritetit kontraktor kapacitetet teknike që disponon një operator ekonomik.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e*

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet teknike, organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.7. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi në rastin konkret nuk është paraqitur dokumenti vërtetim i lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sipas kriterit të përcaktuar në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit.

III.1.9. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63, pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur”, me nr. REF-65966-07-20-2020 me objekt: “Loti 3 - Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 28,557,137 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.08.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve te Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1105;Protokolli

Datë 11.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri